



Prishtinë, 19 nëntor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1451_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.8, Nenit 30, Nenit 32 paragrafin 2, nënparagrafi 2.3 dhe paragrafin 3, Nenit 34 dhe Nenit 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 15 të Ligjit për Energjinë Termike (Ligji Nr. 05/L-052);
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Nr.07/2017);
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Shpërndarjes së Energjisë, të dorëzuar në Rregullator me datë 13.04.2021 nga ndërmarrja Ngrohtroja e Qytetit SH.A., adresa: Rezinë, Gjakovë, (Lokacioni Rezinë) Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 19 nëntor 2021, nxori këtë:

VENDIM

I. Vazhdohet LICENCA për Shpërndarje të Energjisë Termike, ndërmarrjes Ngrohtroja e Qytetit SH.A, me numër licence ZRRE/Li_03/17, për periudhën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, nga data 19.11.2021 deri me datë 18.11.2036.

II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për Ngrohtroja e Qytetit SH.A të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 13.04.2021 ka pranuar nga Ndërmarrja Ngrohtroja e Qytetit Sh.A. Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Vazhdim të Licencës Nr. ZRRE/Li_03/17 për aktivitetin e Shpërndarjes së Energjisë Termike.
- o Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duke dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
- o Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja Ngrohtroja e Qytetit SH.A. me datë 23.09.2021 ka njoftuar palët e interesit përmes gazetave, se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të të Shpërndarjes së Energjisë termike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim nga palët e interesit, për këtë aplikacion.



- Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- Bordi i Rregullatorit ka vlerësuar se ndërmarra në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të sipërpërmendur dhe legjislacionit tjetër në fuqi. Kështu duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- Licenca e lëshuar me datë 04 Tetor 2006, (Nr. i Licencës ERO/Li_03/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_03/12), e modifikuar më 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_03/17) do të vazhdoj të jetë e vlefshme për një periudhë nga data 19.11.2021 deri më 18.11.2036 në pajtim me pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.
- Licenca e lëshuar do të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

I. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

II. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

**bashkëngjitur licenca*

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes Ngrohtorja e Qytetit SH.A
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Bushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar